



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 185/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

| | |
|---------------|------------|
| Evis Shurdha | Kryetar |
| Enkeleda Bega | Nënkryetar |
| Vilma Zhupaj | Anëtar |
| Lindita Skeja | Anëtar |
| Merita Zeqaj | Anëtar |

Në mbledhjen e datës 01.06.2020 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** “Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Delia Impex” shpk, nga procedura e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. *REF-52039-02-28-2020*, me objekt “Ndërtim parcela të reja varrezash”, me fond limit 7.916.225 lekë pa tvsh (ku financimi për vitin 2020 është 3.333.333 lekë pa tvsh, ndërsa për vitin 2021 është 4.582.892 lekë pa tvsh), zhvilluar në datën 20.03.2020, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër”.
- Ankimues:** “Delia Impex” shpk.
Kutia postare 166, Shkodër.
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Shkodër.
Rr. “13 Dhjetori“, Nr.1, Shkodër.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga ankimuesi, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.2. Ankimuesi ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.3. Nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik, pa i hyrë vlerësimit të çështjes *ratione materiae*, vlerëson të ndalet tek respektimi i kërkesave formale (afateve) të ankimimit.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 02.03.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-52039-02-28-2020, me objekt “Ndërtim parcela të reja varrezash”, me fond limit 7.916.225 lekë lekë pa tvsh (ku financimi për vitin 2020 është 3.333.333 lekë pa tvsh, ndërsa për vitin 2021 është 4.582.892 lekë pa tvsh), zhvilluar në datën 20.03.2020, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër”.

II.2. Në datën 20.03.2020 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.3. Në datën 29.04.2020, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

II.4. Referuar materialeve të administruara, si dhe parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik “Delia Impex” shpk konstatohet se ky i fundit, në datën 06.05.2020, ka dorëzuar ankim pranë autoritetit kontraktor, me anë të të cilit kundërshton vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit objekt ankimi.

II.5. Referuar materialeve të administruara, parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, si dhe dokumentacionit dorëzuar nga ky i fundit pjesë e ankimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se është dorëzuar gjithashtu edhe akti administrativ nr.6228/9 prot, datë 14.05.2020, trajtim i ankesës së ankimuesit nga ana e autoritetit kontraktor.

II.6. Në datën 26.05.2020 ankimuesi ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës si dhe dokumentacionit bashkëngjitur,

Arsyeton

III.1. Në datën 02.03.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-52039-02-28-2020, me objekt “Ndërtim parcela të reja varrezash”, me fond limit 7.916.225 lekë pa tvsh (ku financimi për vitin 2020 është 3.333.333 lekë pa tvsh, ndërsa për vitin 2021 është 4.582.892 lekë pa tvsh), zhvilluar në datën 20.03.2020, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër”.

III.2. Në datën 20.03.2020 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III.3. Në datën 29.04.2020, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

III.4. Referuar materialeve të administruara, si dhe parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik “Delia Impex” shpk konstatohet se ky i fundit, në datën 06.05.2020, ka dorëzuar ankim pranë autoritetit kontraktor me anë të të cilit kundërshton vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e tij, nga procedura e prokurimit objekt ankimi.

III.5. Referuar materialeve të administruara, parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, si dhe dokumentacionit dorëzuar nga ky i fundit pjesë e ankimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se është dorëzuar gjithashtu edhe akti administrativ nr.6228/9 prot, datë 14.05.2020, trajtim i ankesës së ankimuesit nga ana e autoritetit kontraktor, akt për të cilin operatori ekonomik ankimues pretendon se ka marrë dijëni në datën 19.05.2020 me anë të postës shqiptare.

III.6. Në datën 26.05.2020 ankimuesi ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

III.7. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, 2, 5 dhe 6, të ligjit nr. 9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të cilin është parashikuar:

1. Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.

1.1 Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni.

2. Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.

5. Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës.

6. Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor”.

III.8. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar si edhe parashtrimeve me shkrim të ankimuesit, konstatohet se ankesa e këtij të fundit është depozituar pranë autoritetit kontraktor në datën 06.05.2020, referuar kjo shkresës kthim përgjigje të trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik nga ana e autoritetit kontraktor, dokument ky për të cilin ankimuesi është vënë në dijeni pasi e ka paraqitur bashkëngjitur ankesës së tij të depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Ankimuesi pretendon se në datën 19.05.2020 ka marrë dijëni për kthimin e

përgjigjes së autoritetit kontraktor me shkresën që mban datën 14.05.2020, me anë të postës shqiptare.

Rezulton se pas kthimit të përgjigjes nga autoriteti kontraktor, ankimuesi ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik në datën 26.05.2020.

Referuar ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar”, parashikohet se, ankimi administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik dorëzohet me shkrim brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor” .

Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se ankimuesi ka ezauruar ankimin administrativ pranë autoritetit kontraktor brenda afatit të parashikuar nga neni 63 pika 2 të L.P.P.-së. Me marrjen e ankesës në dorëzim nga autoriteti kontraktor, ky i fundit ka detyrimin ligjor të shqyrtojë ankesën dhe të marrë një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës.

Mos respektimi i afatit të sipërcituar nga ana e autoritetit kontraktor nuk cënon në asnjë rast pozitën e operatorëve ekonomikë ankimues, pasi kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar edhe momentin procedural të nisjes së llogaritjes së afateve ligjore për ankim administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në rastet kur autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit të parashikuar nga neni 63 pika 5 të LPP-së.

Sa më sipër, K.P.P konstaton se ankimi i dorëzuar nga ankimuesi më datë 26.05.2020 është dorëzuar jashtë afatit të parashikuar nga lex specialis, pasi referuar parashikimeve të sipërcituar, llogaritja e afatit për ankim pranë KPP nis nga dita e nesërme e punës pas përfundimit të afatit të shqyrtimit të ankesës nga autoriteti kontraktor dhe përfundon ditën e dhjetë. Në rastin konkret ankesa e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik në datë 26.05.2020, është depozituar në tejkalim të afateve ligjore.

III.9. Në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSh”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*.

III.10. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, ankesa e dorëzuar nga ankimuesi, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimimit, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga “elementet e domosdoshëm të ankesës” që, referuar nenit 26, pikës 3, shkronja “a”, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, për shkak të mosrespektimit të afateve të ankimimit. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij se, për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve (ndër to dhe ai i ankimimit), është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

III.11. Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimitimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin në fjalë, ankimi administrativ i paraqitur nga operatori ankimues pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik nuk mund të konsiderohet si ezaurim i afateve ligjore që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj të vetë ankimuesit, ankimimi nuk është realizuar sipas kriterëve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga ankimuesi “Delia Impex”, për procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-52039-02-28-2020, me objekt “Ndërtim parcela të reja varrezash”, me fond limit 7.916.225 lekë lekë pa tvsh (ku financimi për vitin 2020 është 3.333.333 lekë pa tvsh, ndërsa për vitin 2021 është 4.582.892 lekë pa tvsh), zhvilluar në datën 20.03.2020, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër”.
2. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 461 Protokoli, Datë 26.05.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha